**FLETËUDHËZUES I PAKETIMIT:**
**Informacion për pacientin**

# RIVANOL

Tretësirë për përdorim lokal – 0.1 %
*(Etakridinë laktat monohidrat)*

**Lexojeni me kujdes këtë fletëudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.**

- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos e jepni tek persona të tjerë. Mund t'i dëmtojë ata edhe pse mund të kenë të njëjtat simptoma si ju.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore keqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor që nuk përmendet në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

**Në këtë fletëudhëzues:**


1. Çfarë është Rivanol dhe përse përdoret
2. Përpara se të përdorni Rivanol
3. Si ta përdorni Rivanol
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Rivanol
6. Informacion i mëtejshëm


## 1. ÇFARË ËSHTË RIVANOL DHE PËRSE PËRDORET

Rivanol është një bar që aplikohet lokalisht si dizinfektant dhe antiseptik.

## 2. PËRPARA SE TË PËRDORNI RIVANOL

Mos përdorni Rivanol në qoftë se keni mbindjeshmëri ndaj etakridinë laktat monohidratit ose ndaj çdo derivati tjetër të akridinave.

Rivanol nuk duhet aplikuar në zonën përreth syve.

**Tregoni kujdes të veçantë me Rivanol**
Nuk kërkohet ndonjë kujdes i veçantë gjatë përdorimit lokal të Rivanol tretësirë.

**Marrja e barnave të tjera**
Trajtimi i njëkohshëm me barna të tjera mund të ndikojë ose të ndikohet nga Rivanol. Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë / përdorur ose keni marrë / përdorur kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë. Mos harroni të informoni mjekun tuaj për trajtimin me Rivanol në qoftë se ju jepet ndonjë bar tjetër gjatë trajtimit.

Rivanol nuk duhet të përzihet me tretësira të tjera, sepse mund të formojë flokëza.

**Shtatzënia dhe ushqimi me gji**
Rivanol nuk duhet të përdoret gjatë shtatzënisë duke qenë se nuk ka përvoja në lidhje me përdorimin e tij.
Rivanol nuk duhet të aplikohet gjatë ushqimit të fëmijës me gji, duke qenë se nuk dihet nëse ekskretohet me qumështin e gjirit.

**Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive**
Nuk ka të dhëna që tregojnë nëse Rivanol ka ndikim mbi aftësinë për të drejtuar automjetin dhe përdorur makineri.

## 3. SI TA PËRDORNI RIVANOL

Gjithmonë përdorni këtë bar ekzaktësisht si ju ka thënë mjeku juaj. Ju duhet të këshilloheni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se nuk jeni të sigurt.
Rivanol aplikohet lokalisht në lëkurë 2 herë në ditë në trajtë tretësire të paholluar dhe lihet të veprojë për të paktën 30 minuta.
Rekomandohet të mos përdoret më shumë se 7 ditë pa këshillën e mjekut.
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se ndjeni që efekti i Rivanol është shumë i dobët ose shumë i fortë.

**Udhëzime të rëndësishme për përdorimin**
Tretësira Rivanol 0.1% ngjyros në të verdhë lëkurën, rrobat dhe sende të tjera. Duhet të shmanget kontakti i tretësirës me materialet që mund të ngjyrosen (p.sh. rroba, tapete, linoleume etj.).

**Në qoftë se keni përdorur më shumë Rivanol**
Në qoftë se keni përdorur më shumë Rivanol se sasia që duhet të përdornit, ju mund të vazhdoni trajtimin sipas dozës së rekomanduar. Nuk ka shenja ose simptoma specifike që shoqërojnë përdorimin e tejkaluar të Rivanol.

**Në qoftë se harroni të përdorni Rivanol**
Në qoftë se harroni një dozë (ose më shumë doza), përdorni dozën në vazhdim kur të jetë koha për përdorimin e zakonshëm të saj.
Mos përdorni një dozë të dyfishtë (ose më të lartë) për të plotësuar dozën (dozat) e harruar(a).

**Në qoftë se ndërprisni trajtimin me Rivanol**
Në qoftë se ndërprisni përdorimin e Rivanol, ju mund të rrezikoni suksesin e trajtimit.
Këshillohuni me mjekun tuaj në qoftë se dëshironi të ndërprisni trajtimin me Rivanol.
Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij produkti, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME

Tretësira e etakridinës mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston ato.
Rrallëherë dhe veçanërisht nën efektin e dritës së diellit, etakridina mund të shkaktojë reaksione alergjike të lëkurës, të cilat zhduken shpejt kur trajtimi ndërpritet.
Në disa raste janë vënë re: enjtje e fytyrës, urtikarie, dhimbje koke dhe spazma.
Në disa raste mund të shfaqet inflamacion i lëkurës.
Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet, ose në qoftë se vëreni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletëudhëzues, ju lutemi të lajmëroni mjekun ose farmacistin tuaj.

## 5. SI TA RUANI RIVANOL

Mbajeni larg fëmijëve.
Mos e përdorni pas datës së skadencës, e cila është e shënuar në paketim.
Mos e ruani në një temperaturë më të lartë se 25°C.
Ruajeni në paketimin origjinal për ta mbrojtur nga drita dhe lagështia.

## 6. INFORMACION I MËTEJSHËM

Çfarë përmban Rivanol – tretësirë për përdorim lokal 0.1 %
Lënda vepruese është etakridinë laktat monohidrat.
1 ml tretësirë përmban 1.05 mg etakridinë laktat monohidrat.
*Përbërës të tjerë:* ujë i pastruar.

**Përmbajtja e paketimit**
Kuti me një shishe qelqi 100 ml.

**Mbajtësi i autorizimit të tregtimit (MAT) dhe prodhuesi:**


**PROFARMA Sh.a.**
Rruga "Myslym Keta"
Tel.: 00 355 4 23 89 602
Tiranë - SHQIPËRI



**Ky fletëudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2014.**


SPECIFICATION

CROPING AREA 12 x 19 cm

**PAY ATENTION**, all the layers are visible.
If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.